



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 02/6 prot.,

Datë 24.01.2025

V E N D I M
Nr. 128/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.01.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime”, me Nr. REF-26458-10-25-2024 me objekt “*Supervizim punimesh për objektin: Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njesisë administrative Udenisht, Bashkia Pogradec*”, me fond limit 8 028 361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec.

Ankimues:

Operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK, me NUIS K91810005U, me adresë: Kashar Tiranë, Njësia Administrative Nr. 05, Rruga “Sami Frashëri”, Pallati Nr. 45, Shkalla 01, Kati i parë.

Autoriteti Kontraktor:	Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec, me adresë: Rruga e Gurasit, Guras, Pogradec.
Subjekte të Interesuar:	Operatori ekonomik “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK, me NUIS K51428048I, me adresë: Komuna e Parisit, Rruga "Osman Myderizi", pallati "Shkreli", Tiranë.
Baza Ligjore:	Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V e r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. OE ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. OE ankimues ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. OE ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 28.10.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime*”, me Nr. REF-26458-10-25-2024 me objekt “Supervizim punimesh për objektin: Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njesisë administrative Udenisht, Bashkia Pogradec”, me fond limit 8 028 361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec.

II.2. Në datën 07.11.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt- ankimi.

II.3. Në datën 16.12.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. B.O.E “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING “shpk & “ELITE STUDIO” SHPK & CIVIL CONS SHPK 7 024 816,38 I kualifikuar
2. B.O.E “HTS COMPANY” shpk & ”HE & SK 11” shpk 7 024 816,39 I kualifikuar
3. B.O.E “ZETAKONSULT” SHPK & ZENIT & CO” SHPK 7 024 816,39 I kualifikuar
4. B.O.E “HYDRO-ENG CONSULTING” shpk & ”P.C.S COMPANY 7 024 816,39 I kualifikuar
5. Gjeokonsult & CO shpk 7 024 816,39 I kualifikuar

II.4. Në datën 27.12.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 90, datë 30.12.2024,, ku është shpallur fitues BOE “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING “shpk & “ELITE STUDIO” SHPK & CIVIL CONS SHPK.

II.5. Në datën 01.01.2025 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 02/2025 protokoli, me datë 06.01.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/4948 e operatorit ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.02/1 prot., datë 06.01.2025 lidhur me pretendimet që operatori ekonomik “GJEOKONSULT & CO” SHPK, ka parashtruar në formular ankesë.

II.7. Nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA, ka dërguar shkresën përcjellëse me nr. 13/3 prot., datë 13.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 02/2 prot., datë 13.01.2025 me objekt “*Vendim për shqyrtim ankesë*” dërguar me sistem elektronik, është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.8. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA, ka dërguar shkresën përcjellëse me nr. 52 prot., datë 15.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 02/3 prot., datë 17.01.2025 me objekt “*Vendim për shqyrtim ankesë*” dërguar me sistem elektronik, është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të OE ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK”, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet fillimisht në

ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që shqyrtimi i mëtejshëm i ankesës së paraqitur ka lidhje me veprimet autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Marrë shkas nga pretendimet e parashtruara nga OE ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK:

“Në dokumentet standarde të tenderit Shtojca 1. FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE ka një shënim, sipas të cilit përcaktohet se: 5 Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore. Sipas këtij udhëzimi është paraqitur edhe oferta jonë me dy shifra pas presjes dhjetore në vlerën 7,024,816.39. Vlerë e cila është e rrumbullakosur sipas llogaritjeve matematikore me dy shifra pas presjes. Nëse shifrat në tabelën e mësipërme do të ishin me tre shifra pas presjes dhjetore do të ishin vlerat si më poshtë: (sipas tabelës në shtojcën 22. AK nuk mund të kualifikojë dhe aq më tepër të shpallë fitues një oferte me tri shifra pas presjes dhjetore të pa rrumbullakosur dhe të ndryshojë në këtë mënyrë vlerën e paraqitur nga OE TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING sipas interesit të saj dhe jo sipas llogaritjeve të duhura sipas VKM 354. Nëse do të bazohemi në njoftimin e vlerësimit ku AK ka vendosur dhe ofertat financiare të operatorëve ekonomikë, oferta e TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING është në vlerë 7,024,816.38 (vlerë e cila është nën kufirin minimal të lejuar sipas VKM 354, duke e bërë këtë ofertë objekt skualifikimi). Por AK për ta mbajtur brenda normës së lejuar të uljes sipas VKM 354 ka dhënë shpjegimin “vlera e operatorit ekonomik ofertuar në formularin e ofertës është 7.024.816,388 pa tvsh”. Pra AK ka shpallur fitues një OE i cili në të vërtetë në të dyja rastet duhet të ishte skualifikuar, pasi nëse do të bazoheshim në rastin e ofertës me tri shifra pas presjes, ai operator nuk ka respektuar kërkesat e DST, nëse do të bazoheshim në rastin ku oferta e tyre do të ishte 7,024,816.38, ai operator nuk ka respektuar VKM 354”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se:

III.1.2. Në shtojcën 1 “Formulari I Ofertës Ekonomike” të dokumenteve të tenderit autoriteti kontraktor ka parashikuar si vijon”

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE¹

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

¹ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	

Datë _____	
------------	--

III.1.3. Në përmbushje të shtojcës 1 të dokumenteve të tenderit, operatori ekonomik

“TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK ka dorëzuar:

-Shtojca 1 “Formulari i Ofertës Ekonomike”, ku çmimi i ofertës pa Tvsh është 7,024,816.388 lekë.

III.1.4. Në dokumentet standarde të tenderit të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit, [Procedurë e Hapur e Thjeshtuar-Shërbime](#), në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës Ekonomike”, është përcaktuar:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE²

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (d) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (e) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (f) Ne ofrojmë t’i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve

² Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.

(d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

(g) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

(h) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

III.1.5. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Pogradec SHA, ka dërguar shkresën përcjellëse me nr. 52 prot., datë 15.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 02/3 prot., datë 17.01.2025 me objekt “Vendim për shqyrtim ankese” dërguar me sistem elektronik, është depozituar nga autoriteti kontraktor, informacioni mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

III.1.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.7. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktorë garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktorë nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktorë janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.8. Në nenin 23 “Kompetencat e Agjencisë së Prokurimit Publik” pika “c” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“Agjencia e Prokurimit Publik për përmbushjen e detyrave të saj kryen këto funksione:

.....

c) miraton me vendim dokumentet standarde të tenderit, që do të përdoren në procedurat e prokurimit sipas rregullave të prokurimit publik;”

-VENDIM nr. 08, datë 23.09.2024 “Për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar””. (nr. 6571/1 prot., datë 23.09.2024).

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik, sa më sipër analizon, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

III.1.10. Komisioni gjykon gjithashtu, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, të barazisë dhe të mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

Në shtojcën nr. 1 “FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE³”, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, miratuar nga

³ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Agjencia e Prokurimit Publik me VENDIM nr. 08, datë 23.09.2024 “Për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar””. (nr. 6571/1 prot., datë 23.09.2024), është shënimi që “*Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore*”.

Duke marrë shkas nga pretendimi i OE ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK me ofertë 7,024,816.388 lekë pa Tvsh (pra, me tri shifra pas presjes dhjetore) dhe pas ballafaqimit të saj me përmbajtjen e DST të hartuara nga autoriteti kontraktor dhe atyre të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, KPP vëren, se autoriteti kontraktor në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi për prokurimin publik dhe me përmbajtjen e DST të miratuara nga APP sipas kompetencave që i njeh ligji (konkretisht nenin 23 pika “c” e LPP-së), ka vlerësuar ofertën e operatorit ekonomik “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK me ofertë 7,024,816.388 lekë pa Tvsh (pra, me tri shifra pas presjes dhjetore) duke kualifikuar këtë ofertues. Komisioni gjykon, se në fazën në të cilën ndodhet procedura e vlerësimit për dorëzimin e Formularit të ofertës ekonomike sipas shtojcës 1, DST e miratuara nga APP për procedurën e hapur e thjeshtuar të llojit shërbim, e ka të përcaktuar qartësisht dokumentacionin që duhet të plotësohet dhe të ngarkohet në SPE. Konkretisht përcaktohet se:

Shtojca 1.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁴

Shënimi: Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore

KPP gjykon se, autoriteti kontraktor pa të drejtë ka kualifikuar operatorin ekonomik “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK, pasi Formulari i ofertës Ekonomike e paraqitura prej tij, nuk është plotësuar në përputhje me të dhënat e kërkuara të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, në shtojcën nr. 1 “FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵”, pjesë e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar, miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publik me VENDIM nr. 08, datë 23.09.2024 “Për miratimin e dokumenteve standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar””. (nr. 6571/1 prot., datë 23.09.2024), është shënimi që “Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi të përcaktuar nga autoriteti kontraktor. Ndërsa formulari i ofertës ekonomikë (shtojca 1) e operatorit ekonomik “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK është me vlerë 7,024,816.388 lekë pa Tvsh, pra, me tri shifra pas presjes dhjetore në kundërshtim me atë të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor.

⁴ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Gjithashtu, Komisioni thekson se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Për sa më sipër argumentuar, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të skualifikojë operatorin ekonomik “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK, i cili nuk ka paraqitur një formular oferte ekonomike në përputhje me atë të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK”, qëndron.

Në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga OE ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK” në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar-shërbime*”, me Nr. REF-26458-10-25-2024 me objekt “*Supervizim punimesh për objektin: Ndërtim i sistemit të kanalizimeve të Njesisë administrative Udenisht, Bashkia Pogradec*”, me fond limit 8 028 361,587 (tetë milion e njëzet e tetë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e një presje pesëqind e tetëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec.
2. Autoriteti kontraktues të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim, duke skualifikuar operatorin ekonomik “TRANSPORT HIGHWAY CONSULTING” SHPK.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga OE ankimues “GJEOKONSULT & CO” SHPK”.

5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi t'i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

